

**LIGJ**  
**Nr. 45/2015**

**PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT PËR DOKUMENTET  
E ISH-SIGURIMIT TË SHETITIT TË REPUBLIKËS POPULLORE  
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 114/2020, datë 29.7.2020; nr. 72/2022, datë 20.10.2022)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

**Qëllimi dhe objekti**

*(shtuar togfjalësh në pikën 3 me ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022)*

1. Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës nga çdo i interesuar për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet një procesi demokratik dhe transparent, mbrojtjes së personalitetit të individit, si dhe unitetit e pajtimit kombëtar.

2. Për realizimin e këtij qëllimi, në këtë ligj përcaktohen rregullat për:

a) mbledhjen, administrimin, përpunimin dhe përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;

b) organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit;

c) njohjen e personave me të dhënat e ruajtura nga ish-Sigurimi i Shtetit për ta;

ç) vënien në dispozicion të institucioneve shtetërore dhe joshtetërore të informacioneve të domosdoshme për qëllimet e parashikuara në këtë ligj;

d) detyrimet e autoriteteve publike dhe arkivave për vënien në dispozicion, për qëllime të zbatimit të këtij ligji, të dokumenteve të disponuara prej tyre.

3. Në funksion të zbatimit të këtij ligji, autoritetet publike i referohen dhe zbatojnë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, për aq sa është e mundur, edhe legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, arkivat dhe informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” si dhe Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 2

**Fusha e veprimit**

*(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 114/2020, datë 29.7.2020; shtuar togfjalësh në pikën 1 me ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022)*

1. Ky ligj zbatohet për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë për periudhën 29 nëntor 1944 deri në ditën e krijimit të Shërbimit Informativ Kombëtar, 2 korrik 1991, të cilat disponohen nga të gjitha arkivat e rrejtit arkivor të Republikës së Shqipërisë dhe që lidhen kryesisht, por pa u kufizuar me veprat penale politike të parashikuara në ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991, “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të

dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar, pavarësisht nëse është dhënë ose jo një dënim për këto vepra nga organet kompetente të regjimit komunist.

2. Dokumentet që disponohen nga autoritetet publike, persona fizikë dhe personat juridikë privatë, do të konsiderohen si dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, vetëm pasi të verifikohet vërtetësia dhe origjina e prejardhjes së tyre nga fondi i ish-Sigurimit të Shtetit.

### Neni 3 Përkufizime

*(ndryshuar pika 2, 4 e 8, shtuar pika 4/1 me ligjin nr. 114/2020, datë 29.7.2020; shtuar togfjalësh dhe ndryshuar fjalë në pikën 4 me ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022)*

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Arkiva” ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për arkivat.
2. “Autoriteti” është Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, organ kolegjal me kompetencat dhe përgjegjësitë sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe që organizohet e funksionon sipas parashikimeve të këtij ligji dhe Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit.
3. “Autoritet publik” është:
  - a) çdo organ përfaqësues i pushtetit qendror dhe vendor dhe administratat përkatëse, duke përfshirë dhe organet me natyrë këshillimore, në nivel kombëtar ose vendor;
  - b) institucione të tjera shtetërore, të ndryshme nga ato të përcaktuara në shkronjën “a” të kësaj pike;
  - c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike; dhe
  - ç) çdo person fizik ose juridik që ushtron përgjegjësi ose funksione publike ose që ofron shërbime publike nën kontrollin e autoriteteve, të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike.
4. “Bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit” është çdo person që vërtetohet se ka bashkëpunuar në mënyrë të fshehtë me organet e ish-Sigurimit të Shtetit, në veprimtari të karakterit politik, që lidhen kryesisht, por pa u kufizuar me veprat penale politike të parashikuara në ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991, “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar, pavarësisht nëse është dhënë ose jo një dënim për këto vepra nga organet kompetente të regjimit komunist, për të cilët disponohen dokumente, kartela ose regjistrime në indeksat e kartotekave të ish-Sigurimit të Shtetit.
- 4/1. “Anëtarë të ish-Sigurimit të Shtetit” janë punonjësit që kanë qenë në marrëdhënie pune, të cilët kanë pasur funksione zyrtare në strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit, ku përfshihen: oficer, nënoficer, nëpunës, punonjës operativ deri te punonjësi i nivelit të lartë drejtues i ish-Sigurimit të Shtetit.
5. “Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit” janë:
  - a) të gjitha mjetet bartëse të informacioneve, të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, të disponuara prej tij apo që i janë vënë në përdorim, pavarësisht nga forma e ruajtjes, veçanërisht, por pa u kufizuar:
    - i) dosje, të dhëna, shkresa, harta, plane, filma, regjistrime me figurë, me zë dhe regjistrime të tjera;
    - ii) riprodhimet, kopjimet e tyre dhe dublikata të tjera, të cilat janë fotokopjuar dhe administruar në bazë të akteve ligjore e nënligjore; si dhe
    - iii) mjetet ndihmëse të domosdoshme për të bërë interpretime, veçanërisht programet për përpunimin automatik të të dhënave;
  - b) dokumentet e gjykatave dhe të prokurorive, për aq sa disponon fondi i ish-Sigurimit të Shtetit;
  - c) dokumente të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe organizatave politiko-shoqërore që kanë lidhje me veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit, vetëm në masën dhe sipas përcaktimeve të nenit 2, pika 1, të këtij ligji.
6. “Kërkues” është personi që ka paraqitur një kërkesë me shkrim pranë Autoritetit, në zbatim të këtij

ligji.

7. “I favorizuar” është çdo person, i cili vërtetohet se:

a) është përkrahur nga ish-Sigurimi i Shtetit, veçanërisht duke i siguruar avantazhe në profesion apo avantazhe ekonomike;

b) është mbrojtur nga ish-Sigurimi i Shtetit apo, me ndërhyrjen e këtij të fundit, është mbrojtur nga ndjekja penale;

c) ka përgatitur apo ka kryer vepra penale me dijeninë apo mbështetjen e ish-Sigurimit të Shtetit.

8. “Person i zhdukur”, sipas fushës së veprimit të këtij ligji, është personi i arrestuar, i burgosur, i rrëmbyer ose të cilit i është hequr liria në çdo formë tjetër nga agjentë të shtetit apo nga persona të tjerë a grupe personash, që kanë vepruar me autorizimin, mbështetjen ose miratimin e shtetit, pasuar nga mohimi i pranimit të heqjes së lirisë ose nga fshehja e fatit të personit të zhdukur a e vendit ku gjendet ai, duke e shkëputur nga mbrojtja e ligjit.

9. “Person” është çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, si dhe personat pa shtetësi.

10. “Palë e tretë” është çdo person tjetër, i ndryshëm nga ata të përcaktuar në pikën 9, të këtij neni, për të cilin ish-Sigurimi i Shtetit ka grumbulluar të dhëna, në mënyrë të fshehtë ose të hapur.

11. “Person i prekur” është çdo person, ndaj të cilit vërtetohet se ish-Sigurimi i Shtetit ka grumbulluar të dhëna në mënyrë të qëllimtë, duke përfshirë edhe mbledhjen e të dhënave në mënyrë të fshehtë apo përmes përgjimeve. Në këtë kategori nuk bëjnë pjesë:

a) bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të Shtetit, kur grumbullimi i të dhënave për ta i ka shërbyer vetëm kontaktimit, rekrutimit në favor të ish-Sigurimit të Shtetit apo vetëm kontrollit të veprimtarisë së tyre në favor të tij; dhe

b) të favorizuarit, kur grumbullimi i të dhënave për ta i ka shërbyer vetëm kontaktimit të tyre apo kontrollit të qëndrimit të tyre, në lidhje me përfitimet prej veprimtarisë në favor të ish-Sigurimit të Shtetit.

12. “Rrjeti arkivor i Republikës së Shqipërisë” përfshin të gjitha institucionet dhe arkivat ekzistuese dhe të krijuara në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat.

13. “Procese politike të posaçme” janë proceset e hetimit dhe të gjyqimit, të ngritura posaçërisht me dispozita procedurale të posaçme, nga organet drejtuese të shtetit komunist, gjatë periudhës 29 nëntor 1944 deri më 2 korrik 1991.

#### Neni 4 Parimet

Mbledhja, administrimi, përpunimi, përdorimi dhe informimi mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit udhëhiqet nga parimet e:

a) ligjshmërisë;

b) mbrojtjes së interesit publik dhe sigurisë kombëtare;

c) pajtimit dhe unitetit kombëtar;

ç) informimit të publikut me informacionin zyrtar;

d) mbrojtjes së të drejtës për jetë private dhe të dhënave personale;

dh) mbrojtjes së të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar;

e) transparencës;

ë) bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore;

f) efikasitetit dhe efektivitetit.

## Neni 5

### **Rregulla të përgjithshme për mbledhjen e dokumenteve dhe informimin**

*(shtuar pika 1.1 dhe 1.2 me ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022)*

1. Autoriteti mbledh, ruan, administron dhe përdor dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, sipas këtij ligji, duke përdorur, sipas nevojës, edhe informacionet nga regjistri qendror i gjendjes civile.

1.1 Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, organi publik, mund:

a) të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët duke garantuar në çdo rast konfidencialitetin e individëve, që ofrojnë informacion si persona të përfshirë ose në dijeni për rrethanat e çështjes;

b) të marrë dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;

c) të vizitojë dhe të kontrollojë sende apo vende të përfshira.

1.2 Çdo person është i detyruar të bashkëpunojë me Autoritetin kur rezulton se ka dijeni për rrethanat e çështjes, i kërkohet informacion si person i përfshirë ose që ka dijeni për rrethanat e çështjes, apo kur ai vetë disponon informacion që e ndihmon Autoritetin në punën e tij. Autoriteti në zbatim të këtij ligji ka detyrimin të garantojë konfidencialitetin për çdo person që bashkëpunon.

2. Çdo person ka të drejtë të kërkojë nga Autoriteti të informohet nëse në dokumentet e administruara ka informacione për personin e tij dhe t'i marrë këto informacione, kur ka të tilla, sipas këtij ligji.

3. Autoritetet publike dhe subjektet e tjera, të parashikuara nga ky ligj, kanë akses te dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, vetëm për aq sa e lejon ligji.

4. Autoriteti vë në dispozicion të autoriteteve shtetërore përkatëse çdo informacion të siguruar gjatë veprimtarisë së tij, kur kjo kërkohet për qëllime të hetimit dhe ndjekjes penale.

5. Kur personi i prekur, pala e tretë, të afërmit e të vdekurve apo të të zhdukurve, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit paraqesin, në publik, me vullnetin e tyre, dokumente me informacione për personin e tyre, këto informacione lejohet të përdoren për qëllimet për të cilat janë kërkuar, në zbatim të këtij ligji.

6. Me vendim të veçantë dhe të arsyetuar, Autoriteti korrigjon çdo informacion që rezulton i pasaktë, pas konstatimit nga vetë Autoriteti apo verifikimit me kërkesë të personit të interesuar, duke bërë reflektimet përkatëse në dokumente. Ky vendim është i ankimueshëm në gjykatën kompetente për gjykimin e çështjeve adminis-trative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Në varësi të kompleksitetit dhe shkallës së vështirësisë së evidentimit të dokumentacionit, për çdo rast, Autoriteti përgjigjet brenda një afati të arsyeshëm. Rregulla të hollësishme mbi afatet për përgjigje ndaj kërkesave përcaktohen në rregulloren e organizimit dhe të funksionimit të Autoritetit.

## Neni 6

### **Kufizime të përdorimit të të dhënave**

1. Ndalohet përdorimi i të dhënave personale në dëm të personave të prekur apo palëve të treta, kur këto të dhëna janë përfutur në mënyrë të fshehtë apo të paligjshme, me përjashtim të rasteve si më poshtë:

a) të përdorimit për qëllime rehabilitimi të personave të vdekur apo të zhdukur;

b) kur këto të dhëna rezultojnë tërësisht apo pjesërisht të gabuara, për shkak të informacioneve të mbledhura.

2. Autoriteti merr masa për ndalimin e përkohshëm të përdorimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, kur prokuroria ose gjykata përcakton se nga përdorimi i tyre mund të dëmtohet veprimtaria

hetimore, ndjekja penale, ecuria ose përfundimi i një procedimi penal të regjistruar. Ky ndalim përfundon kur përdorimi i dokumenteve nuk përbën më rrezik për procedimin penal.

3. Autoriteti merr masa për ndalimin e përkohshëm ose të përhershëm të të dhënave të ish-Sigurimit të Shtetit, kur gjykon se përdorimi i tyre mund të përbëjë rrezik real për sigurinë kombëtare.

KREU II  
AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT  
TË SHTESTIT

Neni 7

**Statusi i Autoritetit**

*(shtuar fjalë në pikën 4 me ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022)*

1. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është person juridik publik, i pavarur, përgjegjës për zbatimin e këtij ligji, lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to.

2. Autoriteti e ka selinë në Tiranë dhe financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.

3. Autoriteti organizohet dhe funksionon sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe në rregulloren e funksionimit, që miratohet prej tij.

4. Autoriteti i kryen funksionet e tij, të përcaktuara në këtë ligj, në mënyrë kolegjiale. Legjislacioni në fuqi për funksionimin e organeve kolegjiale dhe Kodi i Procedurave Administrative zbatohet për aq sa është e mundur në funksionimin e Autoritetit.

5. Autoriteti ka pavarësi të plotë në vendimmarrje për ushtrimin e funksioneve të veta, që burojnë nga ky ligj apo aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

6. Autoriteti, me kërkesën e tij, pajiset nga Këshilli i Ministrave me mjedise dhe i krijohen kushtet e nevojshme të punës.

Neni 8

**Përbërja e Autoritetit, zgjedhja dhe mandati i anëtarëve të tij**

*(shtuar pika 4 me ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022)*

1. Autoriteti përbëhet nga 5 anëtarë, të zgjedhur nga Kuvendi, mbi propozimet që vijnë nga:

a) dy anëtarë të propozuar nga Kuvendi i Shqipërisë;

b) një anëtar i propozuar nga Këshilli i Ministrave;

c) një përfaqësues i propozuar nga shoqatat e të përndjekurve politikë, nga radhët e kandidatëve të mbështetur nga jo më pak se 28 deputetë;

ç) një përfaqësues i propozuar nga Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, nga radhët e kandidatëve të mbështetur nga jo më pak se 28 deputetë.

2. Mandati i anëtarit të Autoritetit është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

3. Kuvendi zgjedh një kryetar nga radhët e anëtarëve të Autoritetit.

4. Anëtari i Autoritetit, të cilit i ka mbaruar mandati, qëndron në detyrë deri në zëvendësimin e tij.

Neni 9

**Kushtet për t'u zgjedhur anëtar**

*(shtuar dhe ndryshuar fjalë në shkronjën "ë" <sup>1</sup>pikës 1 me ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022)*

1. Anëtar i Autoritetit mund të zgjidhet personi që:

---

<sup>1</sup> Ndryshuar me ndreqjen e botuar në Fletoren Zyrtare nr. 13, datë 24.1.2023.

- a) ka shtetësi shqiptare;
  - b) ka zotësi të plotë për të vepruar;
  - c) ka mbaruar arsimin e lartë, me Diplomë “Master shkencor”, ose tituj të ekuivalentuar me të;
  - ç) gëzon integritet të lartë moral, figurë të pastër etiko-morale dhe është i shquar për përgatitje të lartë profesionale;
  - d) ka jo më pak se 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit;
  - dh) nuk ka qenë i dënuar penalisht me vendim të formës së prerë;
  - e) nuk është anëtar në parti politike;
  - ë) në periudhën e përcaktuar në nenin 2, të këtij ligji, nuk ka qenë anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i degëve të punëve të brendshme, punonjës i organeve të ish-Sigurimit të Shtetit, bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit apo i favorizuar, anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim-Internimeve, hetues, prokuror ose gjyqtar në procese politike, dëshmitar i akuzës në proceset politike, të posaçme, apo denoncues;
  - f) nuk ka konflikt interesi me detyrën;
  - g) plotëson kushtet, kriteret dhe pajiset me certifikatë sigurie, sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.
2. Çdo kandidat për anëtar, përpara emërimit të tij, nënshkruan një deklaratë për mosmbajtjen prej tij të asnjë prej detyrave apo cilësive të përcaktuara në shkronjën “ë”, të pikës 1, të këtij neni.
3. Qenia anëtar i Autoritetit është e papajtueshme me çdo detyrë tjetër shtetërore apo private.

Neni 9/1

**Kompetencat e Kryetarit**

*(shtuar me ligjin nr. 114/2020, datë 29.7.2020)*

Kryetari ka këto kompetenca:

- a) vendos për rendin e ditës, thërret dhe drejton mbledhjet e Autoritetit;
- b) ndjek zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
- c) kujdeset për zbardhjen, publikimin, si dhe zbatimin e vendimeve të Autoritetit;
- ç) përfaqëson Autoritetin në marrëdhënie me të tretët;
- d) drejton administratën e Autoritetit dhe kujdeset për mbarëvajtjen e veprimtarisë së mbledhjeve të Autoritetit duke siguruar edhe dokumentimin e tyre, ndërmjet të tjerave me anë të regjistrimit audio;
- dh) kujdeset për publikimin e veprimtarisë së institucionit në faqen zyrtare apo mjete të tjera komunikimi me publikun;
- e) siguron bashkëpunimin institucional të Autoritetit me institucionet vendase dhe të huaja, si dhe në projekte, nisma rajonale, ndërkombëtare, në përputhje me qëllimin e veprimtarisë së Autoritetit;
- ë) kryeson grupet e punës për nevoja të ndryshme të Autoritetit, në zbatim të parashikimeve të këtij ligji;
- f) propozon kërkesat e Autoritetit për nevoja buxhetore dhe personel apo ndryshime legjislative në organet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi;
- g) në ushtrim të kompetencave të veta nxjerr urdhra në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 10  
**Përgjegjësitë e Autoritetit**

1. Autoriteti ka këto përgjegjësi:
  - a) grumbullimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit për qëllimet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ky ligj;
  - b) vlerësimin, renditjen, evidentimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve, sipas rregullave dhe parimeve të legjislationit në fuqi për arkivat;
  - c) bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me autoritetet publike dhe arkivat për qëllime të zbatimit të këtij ligji;
  - ç) dhënien e informacioneve e të njohimeve mbi dokumentet, si dhe garantimin e shqyrtimit dhe dorëzimin e tyre për kërkuesit;
  - d) mbështetjen e kërkimit shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet garantimit të mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve dhe dorëzimin e dublikatave të dokumenteve;
  - dh) informimin e individëve, institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera të interesuara, sipas këtij ligji.
2. Autoriteti raporton për veprimtarinë e tij përpara Kuvendit, një herë në vit, si dhe sa herë i kërkohet nga Kuvendi.

Neni 11  
**Mbarimi i mandatit**

*(shtuar shkronja “e” në pikën 1 dhe zëvendësuar togfjalësh në pikën 2<sup>2</sup> me ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022)*

1. Mandati i anëtarit të Autoritetit mbaron përpara afatit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 8, të këtij ligji, kur ai:
  - a) jep dorëheqjen;
  - b) vdes;
  - c) i hiqet ose i kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - ç) dënohet me vendim gjyqësor penal të formës së prerë;
  - d) nuk përmbush me korrektësi detyrimet e përcaktuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
  - dh) kryen veprime që cenojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij;
  - e) vërtetohet mbajtja prej tij e një prej detyrave apo cilësive të përcaktuara në shkronjën “e”, të pikës 1, të nenit 9, të këtij ligji.
  - ë) kur mungon pa arsye mbi 1(një) muaj rresht.
2. Kuvendi i Shqipërisë, brenda 15 ditëve nga konstatimi i mbarimit të mandatit të anëtarit të Autoritetit, për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, nis procedurën për zëvendësimin e tij, sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj.

Neni 12  
**Sekretariati teknik**

1. Autoriteti, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, ndihmohet nga sekretariati teknik.
2. Sekretariati teknik vepron në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.
3. Kushtet dhe kriteret për të qenë anëtar i këtij sekretariati, janë të njëjta me ato të anëtarëve të

---

<sup>2</sup> Ndryshuar me ndreqjen e botuar në Fletoren Zyrtare nr. 13, datë 24.1.2023.

Autoritetit, me përjashtim të shkronjave “c” dhe “d”, të pikës 1, të nenit 9, të këtij ligji, ku niveli arsimor përcaktohet në përputhje me funksionin.

4. Sekretariati teknik ka këto përgjegjësi:

- a) ndihmon Autoritetin në kryerjen e funksioneve të tij;
- b) krijon kushtet e nevojshme për realizimin dhe mbarëvajtjen e mbledhjeve të Autoritetit;
- c) përgatit dokumentacionin e nevojshëm për zhvillimin e mbledhjeve të Autoritetit;
- ç) kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet për funksionimin e duhur të Autoritetit, në lidhje me çështje që përfshihen në fushën e veprimtarisë së tij.

5. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të sekretariatit teknik i nënshtrohen legjislacionit të punës.

6. Struktura dhe organika e sekretariatit teknik miratohet nga Kuvendi, me propozim të Autoritetit.

7. Punonjësit e sekretariatit teknik duhet të plotësojnë kushtet, kriteret dhe pajisen me certifikatë sigurie, sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

8. Rregulla të hollësishme për funksionimin dhe veprimtarinë e sekretariatit teknik përcaktohen në rregulloren e brendshme të Autoritetit.

### KREU III MBLEDHJA E DOKUMENTEVE

#### Neni 13

#### **Identifikimi i dokumenteve**

1. Autoritetet publike dhe rrjeti arkivor i Republikës së Shqipërisë mbështesin Autoritetin në kërkimet e tij për gjetjen e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe në mbledhjen e tyre.

2. Kur autoriteti publik ose arkivi është në dijeni apo konstaton, gjatë përmbushjes së detyrave, se zotëron dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit apo kopje ose dublikata të tjera të dokumenteve të tilla, vë menjëherë në dijeni Autoritetin.

3. Kur Autoriteti vlerëson se dokumente të caktuara mund të gjenden pranë një autoriteti publik apo arkivi, u drejtohet atyre me kërkesë me shkrim për identifikimin dhe vënien në dispozicion të dokumenteve.

4. Kur autoriteti publik ose arkivi merr një kërkesë, sipas përcaktimeve të pikës 3, të këtij neni, i përgjigjet Autoritetit, brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës, duke i vënë në dispozicion, sipas rastit, dokumentet ose kopje apo dublikata të tyre. Kur dokumenti i kërkuar nuk ndodhet tek autoriteti publik apo arkivi, por këta të fundit kanë dijeni për vendndodhjen e tij, vënë në dijeni Autoritetin.

5. Autoriteti, në mirëkuptim me autoritetet publike dhe arkivat, mund t'i shqyrtojë regjistrimet, arkivat dhe informacionet që gjenden tek to, kur ekzistojnë të dhëna të besueshme se pranë tyre gjenden dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit.

6. Kur personat fizikë ose juridikë privatë janë në dijeni ose konstatojnë se zotërojnë dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit apo kopje ose dublikata të tyre, vënë në dijeni menjëherë Autoritetin.

#### Neni 14

#### **Dorëzimi i dokumenteve nga autoriteti publik dhe arkivi**

1. Çdo autoritet publik dhe arkiv, me kërkesën e Autoritetit, i dorëzon atij dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit që gjenden pranë tyre, duke përfshirë kopjet dhe dublikata të tjera.

2. Kur autoritetit publik i nevojiten dokumentet, për t'i përdorur në përmbushjen e funksioneve dhe qëllimeve të tij, sipas parashikimeve të seksionit 2, të kreut IV, të këtij ligji, ai mund të bëjë dublikata të tyre dhe t'i përdorë ato. Dokumentet origjinale lejohen të përdoren si dokumente vetëm për aq sa kjo është e domosdoshme për përmbushjen e detyrës. Në këtë rast, Autoritetit i dorëzohen, në bazë të kërkesës, dublikata.

3. Pavarësisht parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, dokumentet për të prekurit i dorëzohen Autoritetit origjinale dhe të plota.



4. Autoriteti:

- a) nuk ka kufizim në njohjen, studimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve origjinale;
- b) nuk dorëzon te kërkuesi dokumente origjinale, por dokumente dublikatë të nxjerra nga Autoriteti.

Neni 15

### **Dorëzimi i dokumenteve nga personi fizik dhe juridik privat**

1. Çdo person fizik dhe juridik privat i dorëzon menjëherë Autoritetit, me kërkesë të tij, dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit që zotëron, si dhe kopje apo dublikata të tjera, kur këto nuk janë në pronësi të personit fizik apo juridik privat. Vërtetimi i pronësisë i takon personit fizik ose juridik privat. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, konsiderohen në pronësi të personit fizik apo juridik privat dokumentet që ky i fundit, në bashkëpunim me ish-Sigurimin e Shtetit, i ka përgatitur vetë.

2. Kur dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij neni, rezultojnë në pronësi të personit fizik apo juridik privat, ky i fundit i vë ato në dispozicion të Autoritetit për të përgatitur kopje ose dublikata të tyre.

Neni 16

### **Dokumentet e Partisë së Punës së Shqipërisë dhe organizatave të tjera politiko-shoqërore**

1. Autoriteti, në zbatimin e detyrave të tij, sipas këtij ligji, mund të kërkojë nga organet përkatëse informacion për llojin, përmbajtjen dhe vendin e ruajtjes së dokumenteve të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të organizatave të tjera politiko-shoqërore që kanë vepruar gjatë periudhës së përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji.

2. Autoriteti, sipas nevojës, mund të kërkojë të shqyrtojë dokumentet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Me kërkesën e tij, Autoritetit i dorëzohen dublikata të dokumenteve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, kur këto kanë lidhje me veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit dhe i nevojiten për përmbushjen e funksioneve të tij.

4. Parashikimet e këtij neni zbatohen për ato dokumente që janë krijuar nëpërmjet bashkë-veprimit me ish-Sigurimin e Shtetit, me nxitjen apo në zbatim të urdhrave dhe udhëzimeve të tij.

Neni 17

### **Kthimi i dokumenteve nga Autoriteti**

1. Kur për dokumentet që u përkasin autoriteteve publike nuk ka të dhëna se krijimi i tyre është nxitur apo urdhëruar nga ish-Sigurimi i Shtetit, Autoriteti i rikthen ato, me kërkesë të autoriteteve publike apo kryesisht kur konstaton sa më sipër. Autoriteti mund të mbajë kopje ose dublikata të këtyre dokumenteve.

2. Kur gjatë veprimtarisë së tij, Autoriteti ndeshet me dokumente dhe informacione të klasifikuara, sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror", sipas rastit dhe nivelit të klasifikimit, për kthimin e tyre vepron në përputhje me parashikimet e këtij legjislacioni.

Neni 18

### **Arkivimi i dokumenteve**

1. Autoriteti krijon arkivin e tij për mbledhjen, ruajtjen, administrimin dhe përdorimin e dokumenteve. Arkivi organizohet dhe funksionon në përputhje me dispozitat e këtij ligji, rregulloren e Autoritetit dhe legjislacionin në fuqi për arkivat.

2. Autoriteti arkivon të gjitha dokumentet, kopjet dhe dublikatat e mbledhura, sipas parashi-kimeve të këtij ligji.

3. Në arkivin e tij, Autoriteti:

- a) dokumenton kohën, individin, institucionin apo kërkuesin, të cilëve u janë dorëzuar apo përcjellë, pas përfundimit të përpunimit, dokumente apo informacione nga dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit;
  - b) përcakton informacionet që janë futur në sistemet e përpunimit të të dhënave dhe kohën kur janë futur;
  - c) ndalon hyrjet e paautorizuara;
  - ç) ndalon marrjen e aksesit të personave të paautorizuar në dokumentet e ish-Sigurimit dhe sistemet e përpunimit të të dhënave, me të cilët përpunohen informacione prej dokumenteve;
  - d) garanton se dokumentet nuk lexohen, kopjohen, ndryshohen, asgjësohen apo largohen pa autorizim;
  - dh) garanton se transporti i dokumenteve shoqërohet nga të paktën dy anëtarë të Autoritetit, apo persona të autorizuar nga Autoriteti;
  - e) parashikon modele organizimi të tilla, që t'u përgjigjen kërkesave specifike për ruajtjen e të dhënave.
4. Pas kalimit të afatit të ruajtjes, dokumentet e krijuara nga Autoriteti duhet t'i dorëzohen arkivit, nga i cili janë marrë në dorëzim, apo që rrjedhin dokumentet e prodhuara.

## KREU IV E DREJTA PËR INFORMIM DHE VËNIA NË DISPOZICION E DOKUMENTEVE

### Seksioni 1

#### **E drejta për informim e të prekurve, palëve të treta, bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe të favorizuarve**

##### Neni 19

#### **Kërkesa për informim**

1. Personat e interesuar paraqesin kërkesë pranë Autoritetit për t'u informuar për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.
2. Kërkesa për të marrë informacion për dokumentin, për shqyrtimin apo marrjen e tij në dorëzim bëhet me shkrim.
3. Kërkuesi, së bashku me kërkesën, paraqet edhe kopje të kartës së identitetit dhe, në rastin e një përfaqësuesi me prokurë të posaçme, edhe prokurën përkatëse.
4. Kur kërkuesi çmon se kërkesa e tij duhet të trajtohet me përparësi, ai argumenton nevojën dhe urgjencën në kërkesë. Autoriteti pranon se ndodhet përpara nevojës urgjente, kur informacioni i kërkuar nevojitet për qëllime rehabilitimi, dëmshpërblimi, shmangieje të cenimit të jetës private apo të dëmit moral ose vërtetimin e faktit të mosbashkëpunimit me ish-Sigurimin e Shtetit.
5. Autoriteti i jep informacionet me shkrim, përveçse kur është e nevojshme një formë tjetër e dhënies së informacionit.

##### Neni 20

#### **Garantimi i së drejtës për informim**

*(shtuar pika 1.1 me ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022)*

1. Kërkuesit i njihet e drejta për t'u njohur me dokumentet kur ai ka cilësinë e të prekurit, palës së tretë, bashkëpunëtorit apo të favorizuarit të ish-Sigurimit të Shtetit ose është një përfaqësues me prokurë i këtyre të fundit. Kjo e drejtë përfshin njohjen dhe shqyrtimin e dokumenteve origjinale ose dublikatave të tyre.

1.1 Çdo person gëzon të drejtën të njihet me dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe të kërkojë një kopje të tyre në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit, me kusht që kërkuesi të paraqesë të dhëna në kërkesën e tij që mundësojnë lokalizimin e informacioneve. Informacioni jepet vetëm kur angazhimi i nevojshëm për gjetjen dhe vënien në dispozicion të informacionit është në përpjesëtim të drejtë me interesin e argumentuar të kërkuesit në marrjen e këtij informacioni. Kërkuesi mban përgjegjësi për keqpërdorimin e informacionit të marrë.

2. Autoriteti mund ta kufizojë pjesërisht ose plotësisht garantimin e së drejtës për informim, kur të dhënat përbëjnë kërcënim real për Sigurinë Kombëtare.

3. Kur, për shkaqe aftësie të kufizuara, kërkuesi, për të shqyrtuar dokumentet, ka nevojë për ndihmën e një të treti, Autoriteti lejon praninë e të tredit kur kërkuesi deklaron me shkrim se ai është person i besuar dhe ka arsye të mjaftueshme për të besuar nevojën për shoqërim.

4. Kur dokumentet ose dublikatat, përveç informacioneve personale mbi kërkuesin, përmbajnë edhe të dhëna për të prekur të tjerë apo palë të treta, shqyrtimi i dokumenteve origjinale garantohe vetëm kur:

a) kjo miratohet nga të prekurit e tjerë apo palët e treta; ose

b) është e pamundur ndarja e të dhënave mbi të prekurit e tjerë apo palët e treta; ose

c) është e mundur vetëm me përpjekje të pajustificuara dhe nuk ka arsye për të prezumuar se të prekurit e tjerë apo palët e treta kanë interes të ligjshëm në mbajtjen e këtyre informacioneve të fshehta.

5. Kërkuesit i garantohe e drejta për të njohur dhe shqyrtuar edhe dublikata, tek të cilat informacionet personale mbi të prekur të tjerë apo palë të treta janë bërë të palexueshme. Shqyrtimi kryhet në zyrat e Autoritetit.

6. Kërkuesit i dorëzohen dublikata të dokumenteve vetëm pasi janë bërë të palexueshme të dhënat personale për të prekurit e tjerë apo palët e treta.

7. E drejta për njohje, shqyrtim dhe dorëzim të dokumenteve nuk zbatohet për mjetet e parashikuara nga neni 3, pika 5, shkronja “a”, nëndarja “iii”, të këtij ligji. Kur dokumentet nuk mund të gjenden, e drejta për shqyrtim dhe dorëzim shtrihet te dublikatat dhe të dhënat e kartelave dhe skedave të kartotekës, të cilat përdoren për interpretimin e dokumenteve dhe përmbajnë të dhëna personale për kërkuesin.

#### Neni 21

### **E drejta për informim e të prekurve dhe palëve të treta**

1. Autoriteti u jep të prekurve informacion për dokumentet që ekzistojnë dhe që janë përgatitur për ta, me kërkesën e tyre. I prekuri, kur ka të tilla, jep në kërkesë të dhëna, të cilat e mundësojnë gjetjen e dokumenteve.

2. Informacioni nga Autoriteti përmban një përshkrim të dokumenteve ekzistuese dhe të përgatitura për personin e prekur dhe një riprodhim të thelbit të përmbajtjes së tyre. Bazuar në objektin dhe përmbajtjen e kërkesës, informacioni mund të kufizohet në njoftimin se dokumentet ekzistojnë dhe i prekuri mund t'i shqyrtojë ato.

3. Me kërkesë nga i prekuri, Autoriteti i garanton atij shqyrtimin e dokumenteve që ekzistojnë dhe që janë përgatitur për personin e tij, si dhe dorëzimin e dublikatave të dokumenteve. Në dublikata bëhen të palexueshme të dhënat personale mbi të prekur të tjerë apo palë të treta.

4. Kur në dokumentet ekzistuese dhe të përgatitura për personin e prekur, të cilat janë shqyrtuar nga i prekuri, apo për të cilat janë marrë dublikata, ka pseudonime të bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit, që kanë grumbulluar ose vlerësuar informacione mbi të, punonjësve të ish Sigurimit të Shtetit që i kanë përpiluar ato ose personave të tjerë, të cilët kanë informuar me shkrim mbi të prekurin, kur përmbajtja e informacionit të dhënë prej tyre mund të ishte në dëm të të prekurit, me kërkesë të të prekurit, atij i bëhen të ditur emrat e bashkëpunëtorëve, punonjësve të ish Sigurimit të Shtetit dhe personave të tjerë.

5. Pika 4, e këtij neni, nuk zbatohet kur bashkëpunëtori, punonjësi apo informatori i ish-Sigurimit të Shtetit nuk kishte mbushur moshën 18 vjeç në kohën e kryerjes së veprimtarisë kundër të prekurit.

6. Parashikimet e këtij neni zbatohen edhe për palët e treta, me kusht që kërkuesi të paraqesë të dhëna, në kërkesën e tij, që mundësojnë lokalizimin e informacioneve. Informacioni jepet vetëm atëherë, kur angazhimi i nevojshëm për gjetjen dhe vënien në dispozicion të informacionit është në përpjesëtim të drejtë me interesin e argumentuar të kërkuesit në marrjen e këtij informacioni.

#### Neni 22

### **E drejta për informim e të afërmeve të të vdekurve apo të të zhdukurve**

1. E drejta për të kërkuar informacion mbi ekzistencën e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit për personat e vdekur dhe të shpallur të zhdukur, si dhe për shqyrtimin e dokumenteve dhe vënien në dispozicion të dublikatave të tyre, u njihet edhe të afërmeve të tyre, sipas kësaj radhe përparësie:

- a) bashkëshortëve;
- b) fëmijëve;
- c) fëmijëve të fëmijëve, kur personat e parashikuar në shkronjat “a” dhe “b” kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur;
- ç) prindërve, kur personat e parashikuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur;
- d) vëllezërve dhe motrave, kur personat e parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur;
- dh) fëmijëve të vëllezërve dhe motrave, kur personat e radhëve të mësipërme kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur.

2. Të afërmeve u vihet në dispozicion informacioni, sipas pikës 1, të këtij neni, me kërkesë dhe për këto qëllime:

- a) për rehabilitimin e të vdekurve apo të zhdukurve;
- b) për ruajtjen e të drejtave të personalitetit të të vdekurve apo të zhdukurve, në veçanti për sqarimin e akuzës së bashkëpunimit me ish-Sigurimin e Shtetit;
- c) për të qartësuar fatin e të vdekurve apo të të zhdukurve.

3. Të afërmit, sipas pikës 1, të këtij neni, bashkë me kërkesën për informacion, duhet të tregojnë dhe të vërtetojnë, me dokumentet përkatëse, lidhjen e tyre me personin e vdekur apo të zhdukur dhe të argumentojnë qëllimin e kërkesës.

4. Në kërkimin e informacioneve, sipas këtij neni, dhe dhënien e përgjigjeve përkatëse zbatohen, për aq sa është e mundur, përcaktimet e neneve 20 dhe 21 të këtij ligji.

5. Ky nen nuk zbatohet në rastet kur personi i vdekur ose i zhdukur ka shprehur, përpara vdekjes ose zhdukjes, me shkrim, vullnetin e tij për moszbulimin e informacioneve të kërkuara, ose kur ky vullnet mund të provohet qartësisht nga rrethana të tjera objektive ose të dokumentuara.

#### Neni 22/1

### **Bashkëpunimi për identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të të zhdukurve dhe të të ekzekutuarve, si dhe masat për ruajtjen e vendvarrimeve**

*(shtuar me ligjin nr. 114/2020, datë 29.7.2020; zëvendësuar fjalë në titull, në pikën 1, shtuar pika 1.1 me ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022)*

1. Autoriteti bashkëpunon me institucionet shtetërore qendrore dhe vendore apo ndërkombëtare për procesin e identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe për marrjen e masave për të mbrojtur dhe ruajtur në mënyrën më të përshtatshme vendet që janë aktualisht apo do të identifikohen si vendvarrime.

1.1 Në procesin e identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të personave të zhdukur dhe të ekzekutuar, në kuadër të Marrëveshjes së Këshillit të Ministrave me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 83/2018, Autoriteti ndërvepron me Ministrinë e Brendshme për sa u takon instrumenteve ligjore dhe institucioneve në varësi të saj.

2. Rregullat e bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit dhe institucioneve qendrore dhe vendore për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të zhdukur gjatë komunizmit parashikohen në marrëveshje dy apo shumëpalëshe të lidhura për këtë qëllim.

3. Autoritetet përgjegjëse dhe mënyra e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuara ose të

dyshuara përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 23

### **E drejta për informim e bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe të afërmve të tyre** (ndryshuar tituli, ndryshuar fjalia e parë e pikës 1 dhe pikës 2 me ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022)

1. Autoriteti u jep bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe të afërmve të tyre, sipas përcaktimeve të neneve 20 dhe 22 të këtij ligji, informacion për dokumentet që ekzistojnë dhe që janë përgatitur për ta me kërkesë të tyre. Informacioni mund të përfshijë edhe një përshkrim të llojit dhe vëllimit të veprimtarisë, një përshkrim të rrethit të personave, mbi të cilët është raportuar, si dhe periodicitetin e raportimeve.

2. Me kërkesë të tij, bashkëpunëtorit apo të afërmit të tij i garantohet e drejta e njohjes dhe shqyrtimit të dokumenteve të hartuara për të dhe i dorëzohen publikata të tyre. Në publikata duhet të bëhen të palexueshme informacionet personale për të prekurit apo palët e treta.

3. Me kërkesë të tij, bashkëpunëtorit i jepet informacion mbi raportet e përpiluara prej tij dhe i garantohet shqyrtimi i këtyre raporteve, kur ai argumenton interesin e ligjshëm për njohjen me këto dokumente. Pavarësisht këtij parashikimi, interesi i të prekurve apo palëve të treta në ruajtjen e fshehtësisë së informacioneve, është më i lartë se interesi i bashkëpunëtorit.

#### Neni 24

### **E drejta për informim e të favorizuarve**

1. Për garantimin e së drejtës për informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për të favorizuarit zbatohen pikat 1 dhe 2, të nenit 23, të këtij ligji.

2. I favorizuari, në kërkesën e tij për Autoritetin, duhet të japë të dhëna që mundësojnë gjetjen e informacioneve.

3. Pika 1, e këtij neni, nuk zbatohet në rast konkurrimi të interesit të të favorizuarit me një interes publik.

#### Neni 25

### **Tarifat dhe pagesat**

Për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen sipas këtij ligji, tarifat dhe pagesat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Seksioni 2

### **E drejta për informim e institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe personave privatë**

#### Neni 26

### **Informimi i institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera**

1. Autoriteti njofton, u krijon mundësi aksesit te dokumentet dhe u lëshon dokumente institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera të parashikuara në ligj, në masën dhe për qëllimet që e lejon ky ligj.

2. Institucioni kushtetues dhe autoriteti publik i drejtohet Autoritetit me kërkesë për informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për qëllime të përmbushjes së funksioneve të tij.

3. Autoriteti, përpara përgjigjes, kontrollon nëse kërkesa për njoftim, shqyrtim apo dorëzim dokumentesh:

- a) përmban një qëllim të lejueshëm përdorimi;
- b) është në kuadrin e detyrave të kërkuesit dhe deri në çfarë mase;
- c) përdorimi është i domosdoshëm për qëllimin e deklaruar.

4. Për kërkesat e paraqitura nga gjykatat, prokuroritë ose Policia Gjyqësore, për efekt të një procedimi penal të regjistruar, Autoriteti kryen verifikimet e përcaktuara në pikën 3, të këtij neni, dhe, në çdo rast, vepron në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale në fuqi.

5. Autoriteti i jep informacionet me shkrim, përveçse kur është e nevojshme një formë tjetër e dhënies së tyre.

6. Kur kërkuesi çmon se kërkesa e tij duhet të trajtohet me përparësi, ai argumenton nevojën dhe urgjencën në kërkesë. Për qëllime të zbatimit të dispozitave të këtij kreu, konsiderohen nevojë urgjente rastet kur:

- a) informacioni i kërkuar nevojitet për qëllime rehabilitimi, dëmshpërblimi, shmangieje të cenimit të jetës private apo të dëmit moral ose shkarkimin nga akuza e bashkëpunimit me ish-Sigurimin e Shtetit;
- b) informacioni kërkohet për qëllime të verifikimit të personave, sipas parashikimeve të neneve 29 dhe 30 të këtij ligji;
- c) informacioni kërkohet për qëllime të hetimit, ndjekjes penale dhe parandalimit të krimit.

7. Kur njoftimi për ekzistencën e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe përmbajtjes së tyre nuk është i mjaftueshëm, Autoriteti u krijon subjekteve të këtij neni mundësinë e njohjes dhe shqyrtimit të dokumenteve.

8. Autoriteti i dorëzon dokumentet kur subjektet e këtij neni, në kërkesë, argumentojnë se njoftimet dhe shqyrtimi nuk mjaftojnë. Doku-mentet origjinale dorëzohen vetëm kur kjo është e domosdoshme për qëllime të provës në procedimet penale, të regjistruara në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale në fuqi. Dokumentet origjinale të dorëzuara i kthehen menjëherë Autoritetit, sapo nuk nevojiten më për qëllimin e kërkuar. Kur dokumentet përmbajnë të dhëna personale mbi personin, të cilit i referohet kërkesa dhe të dhëna për të prekur të tjerë apo palë të treta, zbatohen pikat 4 dhe 5, të nenit 20, të këtij ligji.

## Neni 27

### **Përdorimi i dokumenteve që nuk përmbajnë të dhëna personale**

*(ndryshuar fjalë në shkronjën "d" të pikës 1, ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 114/2020, datë 29.7.2020; riformuluar shkronja "e" e pikës 1 me ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022)*

1. Autoriteti lejon përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas parashikimeve të këtij kreu, kur ato nuk përmbajnë të dhëna personale mbi të prekur apo palë të treta, për qëllimet e mëposhtme:

- a) rehabilitimin e të prekurve, të të vdekurve apo të të zhdukurve;
- b) dëmshpërblimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- c) ruajtjen e të drejtave të personalitetit dhe shmangies së dëmit moral;
- ç) qartësimin e fatit të të humburve, të të zhdukurve dhe të rasteve të pasqaruara të vdekjeve;
- d) verifikimet e zyrtarëve, në përputhje me kërkesat drejtuar Autoritetit nga institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, sipas nenit 29, të këtij ligji;
- dh) verifikimet e kandidatëve për funksione të zgjedhshme, në përputhje me kërkesat drejtuar Autoritetit prej tyre;
- e) verifikimet e propozimeve për dhënie dekoratash, titujsh nderi, medaljesh dhe titujsh vendorë të nderit, për emërtimin e rrugëve, shesheve, hapësirave publike dhe monumenteve historike, kulturore, lapidarëve, me data, emra dhe simbole që lidhen me të kaluarën e regjimit komunist, sipas përcaktimeve të nenit 30 të këtij ligji.

2. Autoriteti vë në dispozicion dokumentacionin dhe lejon përdorimin e dokumenteve, për qëllime të verifikimit të parashikuar nga shkronja "d" e pikës 1 të këtij neni.

## Neni 28

### **Përdorimi i dokumenteve që përmbajnë të dhëna personale**

*(ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 114/2020, datë 29.7.2020)*

1. Autoriteti lejon përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas parashikimeve të këtij kreu, kur ato përmbajnë të dhëna personale mbi të prekur apo palë të treta, për qëllimet e mëposhtme:

- a) rehabilitimin e të prekurve, të të vdekurve apo të të zhdukurve;
- b) dëmshpërblimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- c) mbrojtjen e së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare;
- ç) qartësimin e fatit të të humburve, të të zhdukurve dhe të rasteve të pasqaruara të vdekjeve;
- d) verifikimet e zyrtarëve, në përputhje me kërkesat drejtuar Autoritetit nga institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, sipas nenit 29 të këtij ligji;
- dh) verifikimet e kandidatëve për funksione të zgjedhshme, në përputhje me kërkesat drejtuar autoritetit prej tyre, sipas nenit 30 të këtij ligji.

Në zbatim të kësaj pike, Autoriteti respekton, për aq sa është e mundur, legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2 Autoriteti vë në dispozicion dokumentacionin dhe lejon përdorimin e dokumenteve për qëllime të verifikimit të parashikuar nga shkronja “d” e pikës 1 të këtij neni.

3. Nëse Autoriteti konstaton, gjatë përmbushjes së detyrave të veta, se në dokumente gjenden informacione për spiunazh, kundërspiunazh ose terrorizëm, në kuptimin e legjislacionit penal të Republikës së Shqipërisë, njofton me iniciativën e tij autoritetet përgjegjëse të inteligjencës dhe sigurisë.

## Neni 29

### **Kërkesa për informim mbi zyrtarë përpara emërimit ose ngritjes në detyrë**

*(ndryshuar pika 2 dhe 4 me ligjin nr. 114/2020, datë 29.7.2020; zëvendësuar togfjalësh shkronjën “c” të pikës 1, shfuqizuar pika 4 me ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022)*

1. Autoriteti ka detyrimin t'i përgjigjet çdo kërkesë të institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike, lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, kur kjo kërkohej në kuadër të vlerësimit, sipas legjislacionit përkatës, të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t'u emëruar ose ngritur në detyra si:

- a) President i Republikës;
- b) anëtarë të Këshillit të Ministrave, zëvendësministra, funksionarë politikë, anëtarë të trupës së nivelit të lartë drejtues në administratën shtetërore dhe pozicione të barasvlershme me to;
- c) anëtarë të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, gjyqtarë e prokurorë në gjykatat e prokuroritë e të gjitha niveleve;
- ç) anëtarë të Gjykatës Kushtetuese;
- d) funksionarë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, Gardën e Republikës, oficerë me gradën “Gjeneral” dhe “Kolonel”;
- dh) prefektë;
- e) drejtues dhe punonjës të Shërbimit Informativ Shtetëror, Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes dhe çdo njësi tjetër të inteligjencës;
- ë) drejtues në Policinë e Shtetit deri në nivel qarku dhe komisariati;
- f) drejtues të përfaqësive diplomatike;
- g) guvernatorë dhe zëvendësguvernatorë të Bankës së Shqipërisë;
- gj) anëtarë të Akademisë së Shkencave, rektorë, zëvendësrektorë, dekanë, zëvendësdekanë në universitetet publike;

h) Drejtor i Përgjithshëm dhe zëvendësdrejtorë të Radiotelevizionit Publik Shqiptar;

i) Drejtor dhe Zëvendësdrejtor i Agjencisë Telegrafike Shqiptare;

j) çdo person tjetër i dekretuar nga Presidenti apo i zgjedhur nga Kuvendi.

2. Autoriteti u përgjigjet institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike për zyrtarin që emërohet ose ngrihet në detyrë, për periudhën e përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji, përkatësisht nëse:

a) ka qenë ose jo person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm;

b) ka qenë ose jo anëtar, bashkëpunëtor, i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

c) figuron ose jo në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit.

3. Institucionet kombëtare dhe autoritetet publike, në kuadër të transparencës dhe në funksion të vlerësimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të zyrtarëve, përpara emërimit ose ngritjes në detyrë, udhëhiqen nga parimi i mosndëshkimit kolektiv dhe respektimit të të drejtave dhe interesave të individit.

4. Shfuqizuar.

Neni 30

### **Kërkesa për informim nga kandidatë për t'u zgjedhur**

*(riformular shkronja "b" e pikës 2 me ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022)*

1. Autoriteti ka detyrimin t'i përgjigjet, sipas pikave 2 dhe 3, të nenit 29, të këtij ligji, çdo kërkesë të paraqitur nga kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetarë bashkish dhe kryetarë këshilli qarku, në lidhje me ekzistencën për ta të informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, kur kjo kërkohet prej tyre për qëllime të transparencës së figurës, gjatë fushatave elektorale.

2. Kur kjo kërkohet nga subjektet dhe për qëllimin e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, Autoriteti i informon ato, sipas pikës 2, të nenit 29, të këtij ligji, për personat që në periudhën e përcaktuar në nenin 2, të këtij ligji, figurojnë si:

a) anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i degëve të punëve të brendshme, anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim Internimeve, hetues, prokuror, gjyqtar në procese posaçme politike, apo punonjës i nivelit të lartë i ish-Sigurimit të Shtetit;

b) bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, denoncues në proceset politike ose dëshmitar i akuzës në proceset politike të posaçme, pas mbushjes së moshës 18 vjeç;

c) persona me të dhëna nga ish-Sigurimi i Shtetit për spiunazh dhe terrorizëm.

3. Kur dokumentet përmbajnë të dhëna personale mbi të prekur të tjerë apo palë të treta, zbatohen pikat 4 dhe 5, të nenit 20, të këtij ligji.

Neni 31

### **Bashkëpunimi me komisionet hetimore parlamentare**

Autoriteti bashkëpunon dhe u vë në dispozicion, me kërkesën e tyre, informacionin e disponuar komisioneve hetimore parlamentare, veprimtaria e të cilëve bën të nevojshme njohjen dhe shqyrtimin e dokumenteve të administruara prej tij.

Neni 32

### **Informimi për qëllime të hetimit, ndjekjes penale, gjykimit dhe parandalimit të krimit**

1. Autoriteti bashkëpunon dhe u vë në dispozicion informacione, me kërkesë të tyre, gjykatës, prokurorisë dhe Policisë Gjyqësore, kur kjo i ndihmon veprimtarisë hetimore, ndjekjes penale, gjykimit të drejtë në procese penale, si dhe parandalimit të krimit apo shmangies së rrezikut për sigurinë publike dhe



kombëtare.

2. Për zbatimin e pikës 1, të këtij neni, zbatohen rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë ligj dhe Kodin e Procedurës Penale.

3. Kur Autoriteti, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, konstaton informacione që përbëjnë arsye për të besuar se ekziston rrezik për vepra penale apo për sigurinë publike, i njofton organet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, kryesisht, pa kërkesë.

Neni 33

### **Informimi për qëllime të shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë**

1. Dokumentet që përmbajnë të dhëna personale mbi personat e prekur apo palët e treta, nuk lejohet të vihen në dispozicion apo të përdoren nga shërbimet e inteligjencës dhe sigurisë apo në favor të tyre, me përjashtim të dokumenteve që përmbajnë të dhëna mbi:

a) punonjësit e shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë, kur përdorimi i të dhënave është i domosdoshëm për të parandaluar rrezikun për këta punonjës apo për shërbimin e inteligjencës;

b) dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit që lidhen me Sigurinë Kombëtare, kur përdorimi i të dhënave është i domosdoshëm për kundër-spiunazhin dhe luftën ndaj krimit të organizuar kombëtar e ndërkombëtar.

2. Dokumentet që nuk përmbajnë të dhëna personale mbi personat e prekur apo palët e treta, lejohen të vihen në dispozicion dhe përdoren nga shërbimet e inteligjencës, për qëllime të përmbushjes së detyrave të tyre ligjore, sipas procedurave të parashikuara në këtë kre dhe sipas akteve të tjera ligjore në fuqi.

Neni 34

### **Përdorimi i informacionit**

Informacionet që lidhen me persona, të marra në përputhje me parashikimet e këtij kreu, përdoren vetëm për qëllimet për të cilat janë kërkuar, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ky ligj.

Neni 35

### **Njoftimi i të prekurve**

1. Kur Autoriteti përcjell informacione, në përputhje me parashikimet e nenit 28, të këtij ligji, të cilat përmbajnë të dhëna personale për persona të prekur, ai i njofton këta të fundit mbi llojin e informacioneve të përcjella dhe marrësin e tyre.

2. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk zbatohet kur Autoritetit i është komunikuar nga kërkuesi i informacionit se njoftimi i përcjelljes së dokumenteve, gjatë periudhës së verifikimit të dokumentacionit, do të rrezikonte sigurinë publike apo do të pengonte zbatimin e ligjit.

Seksioni 3

### **Informimi për qëllime kërkimore, historike dhe i medias**

Neni 36

#### **Informimi për qëllime kërkimore dhe historike**

*(ndryshuar fjalë shkronjën "db" të pikës 1, shtuar pikat 5 e 6 me ligjin nr. 114/2020, datë 29.7.2020; shtuar shkronjat "a" dhe "b" në pikën 5 me ligjin 72/2022, datë 20.10.2022)*

1. Në funksion të veprimtarisë hulumtuese dhe kërkimit shkencor, me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit apo të edukimit qytetar, Autoriteti vë në dispozicion, mbi bazë kërkesë, dokumentet e mëposhtme:

a) dokumente që nuk përmbajnë të dhëna personale;  
b) publikata të dokumenteve, në të cilat janë bërë të palexueshme të dhënat personale;  
c) dokumente që përmbajnë të dhëna personale mbi punonjësit, bashkëpunëtorët ose të favorizuarit e ish-Sigurimit të Shtetit, për veprimtari në favor të ish-Sigurimit të Shtetit, të kryera pas mbushjes së moshës 18 vjeç;

ç) dokumente që përmbajnë të dhëna personale mbi persona të historisë së kohës, mbajtës të funksioneve politike, për aq sa bëhet fjalë për informacione që i përkasin rolit të tyre në historinë e kohës dhe ushtrimit të funksioneve;

d) dokumente të tjera që përmbajnë të dhëna personale, nëse paraqiten miratimet me shkrim të personave të prekur;

dh) dokumente që përmbajnë të dhëna personale mbi të vdekurit, vdekja e të cilëve ka ndodhur të paktën 10 vjet më parë.

2. Dokumentet që përmbajnë të dhëna personale vihen në dispozicion vetëm kur nëpërmjet përdorimit të tyre nuk dëmtohen interesat e ligjshëm dhe të drejtat e personave të përmendur në këto dokumente, në përputhje dhe për aq sa nuk vjen në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Për botimin e të dhënave personale, të siguruara sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohet legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Në zbatimin e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, Autoriteti, kur kjo është e mundur, vë në dijeni personat e prekur për vënien në dispozicion të të dhënave dhe merr në konsideratë kundërshtimet e mundshme të tyre, duke vlerësuar, për çdo rast, interesin privat përkundrejt atij publik.

5. Në funksion të edukimit qytetar, me qëllim informimin e qytetarëve për dokumentet dhe veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit në tërësi, dhe me fokus brezat e rinj në veçanti, Autoriteti zhvillon veprimtari që ndihmojnë në formësimin e vetëdijes civile për rindërtimin e narrativës të së shkuarës komuniste, të mbështetur mbi kërkimin shkencor, brenda fushës së veprimit të këtij ligji:

a) Autoriteti në funksion të veprimtarisë së tij informuese bashkëpunon me muzetë kombëtare të kujtesës, duke vënë në dispozicion të institucioneve të trashëgimisë kulturore dokumentacionin arkivor që disponon dhe bashkëpunon me to për zbardhjen e së vërtetës së krimeve të komunizmit;

b) Autoriteti mbështet organizimin e vizitave shkollore, të nxitura dhe të sugjeruara nga MASR-ja, si pjesë e programit vjetor, në vendet e kujtesës në ditët përkujtimore historike.

6. Autoriteti për realizimin e veprimtarisë sipas këtij ligji, ka të drejtë të përzgjedhë dhe të kontraktojë ekspertë të jashtëm. Paguesa e ekspertëve të jashtëm përcaktohet sipas akteve nënligjore në fuqi.

Neni 37

### **Shqyrtimi i dokumenteve**

*(ç'zëvendësuar fjalë në pikën 1 dhe hiqen fjalë në pikat 1 dhe 2 me ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022)*

1. Për qëllime të kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar, dokumentet, në të cilat figurojnë emrat e palëve të treta, mund të shqyrtohen në zyrën e Autoritetit.

2. Me kërkesë të personave të interesuar, kur shqyrtimi i dokumenteve sipas këtij ligji lejohet, mund të lëshohen publikata, në cilat janë fshirë emrat e palëve të treta. Publikatat nuk mund të përdoren nga marrësi për qëllime të tjera nga ato për të cilat janë kërkuar dhe as të përcillen tek marrës të tjerë.

Neni 38

### **Informimi i medias**

1. Vënia në dispozicion dhe përdorimi i dokumenteve nga media kryhet në përputhje me nenet 36 dhe 37 të këtij ligji.

2. Kur publikimi i të dhënave personale, të siguruara sipas këtij ligji, shoqërohet me deklaratë të kundërta të personave të përmendur, këto deklaratë u bashkëlidhen të dhënave personale dhe ruhen, vihen

në dispozicion e lejohet të publikohen, në të ardhmen, vetëm së bashku me deklaratat kundërshtuese.

#### Seksioni 4

### **Kundërshtimi i veprimeve të Autoritetit**

#### Neni 39

### **Kërkesa për korrigjime**

1. Kur kërkuesit e dokumenteve, sipas përcaktimeve të këtij kreu, si dhe personat e përmendur në to konstatojnë se në dokumentet dhe të dhënat e vëna në dispozicion nga Autoriteti ka pasaktësi, ata vënë në dijeni Autoritetin, duke paraqitur kërkesë për korrigjimin e të dhënave.

2. Kërkesa për korrigjimin e të dhënave përmban evidentimin e plotë të informacionit të pasaktë, arsyet e vlerësimit të këtij informacioni si të pasaktë, identifikimin e pjesëve ku ka vend për saktësime, si dhe të dhëna apo dokumente që vërtetojnë pretendimet për pasaktësi dhe që ndihmojnë në saktësimin e informacionit. Kur kërkuesi nuk disponon të dhëna apo dokumente të tilla, por është në dijeni të vendndodhjes së tyre, ai vë në dijeni Autoritetin për këtë fakt.

#### Neni 40

### **Korrigjimet**

1. Me marrjen e një kërkesë, sipas nenit 39, të këtij ligji, Autoriteti vihet në lëvizje për të verifikuar pretendimet e kërkuesit.

2. Kur nga dokumentet e paraqitura nga kërkuesi, sipas pikës 2, të nenit 39, të këtij ligji, apo nga kërkimet e Autoritetit provohet pretendimi për pasaktësi, Autoriteti bën korrigjimet përkatëse në dokumentin e prodhuar nga vetë Autoriteti, një kopje e të cilit i bashkëngjitet dokumentit origjinal. Në çdo rast korrigjimi bëhet me vendim të arsyetuar dhe mund të ankimohet në gjykatën kompetente për gjykimin e çështjeve admini-strative.

3. Dokumentet e korrigjuara, sipas këtij neni, ruhen dhe vihen në dispozicion, në të ardhmen, së bashku me korrigjimet përkatëse.

#### Neni 41

### **Ankimi gjyqësor**

Ndaj refuzimit të Autoritetit për t'iu përgjigjur një kërkesë për informacion, sipas këtij kreu, paraqitet ankimi në gjykatën kompetente për gjykimin e çështjeve administrative.

#### KREU V

### **DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

#### Neni 42

### **Kundërvajtjet administrative**

*(shtuar shkronjat "c" dhe "d" në pikën 1 me ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022)*

1. Në kuptim të këtij ligji, kur nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë shkeljet e mëposhtme:

- a) mosvënia në dijeni e Autoritetit, sipas parashikimeve të pikës 6, të nenit 13, të këtij ligji;
- b) mosdorëzimi i dokumenteve Autoritetit, sipas parashikimeve të nenit 15 të këtij ligji;
- c) mosrespektimi i detyrimeve të marrësit sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 37, të këtij ligji.
- d) refuzimi ose shmangia nga detyrimi për bashkëpunim sipas parashikimeve të pikës 1.2, të nenit 5, të këtij ligji.

2. Në konstatimin e shkeljes, marrjen e vendimit dhe përcaktimin e masës së gjobës për çdo kundërvajtje, Autoriteti zbaton legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Neni 43  
**Aktet nënligjore**

1. Këshilli i Ministrave, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton aktet nënligjore për procedurën e kalimit në administrim të Autoritetit të materialeve arkivore, të parashikuara nga nenet 14 dhe 15, mënyrën e ruajtjes fizike të tyre, si dhe tarifatat e pagesat, të parashikuara nga neni 25 i këtij ligji.

2. Autoriteti, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tij, mbështetur në parimet e parashikuara nga neni 4 i këtij ligji.

Neni 44  
**Dispozitë kalimtare**  
*(shtuar pikat 4 dhe 5 me ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022)*

1. Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kuvendi zgjedh anëtarët e Autoritetit.

2. Brenda dy muajve nga ngritja e Autoritetit, rrjeti arkivor i Republikës së Shqipërisë paraqet informacion pranë Autoritetit dhe vë në dispozicion të tij informacionet dhe dokumentet e kërkuara prej tij, sipas këtij ligji.

3. Brenda tre muajve nga fillimi i funksionimit të Autoritetit, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe SHISH-i duhet të kenë kaluar në administrim tek Autoriteti të gjithë arkivin e ish-Sigurimit të Shtetit.

4. Të deklasifikohen të gjitha dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të parashikuara në këtë ligj për periudhën 29 nëntor 1944 deri në ditën e krijimit të Shërbimit Informativ Kombëtar, 2 korrik 1991, të cilat disponohen nga të gjitha arkivat e rrjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë.

5. Autoriteti përgjegjës për grumbullimin dhe administrimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, kur gjatë punës ndeshet me dokumente që përmbajnë informacione që lidhen me cenimin e sigurisë kombëtare, i klasifikon ato sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

Neni 45  
**Shfuqizime**  
*(reformular me ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022)*

Nenet 14 dhe 16, të ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, i ndryshuar, dhe çdo dispozitë ligjore që vjen në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 46  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.4.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9113, datë 22.5.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**